



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr. 2221/1 Prot

Tiranë, më 16/08/2020

Lënda: Njoftim për shpallje të lëvizjes paralele

SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE _____
DREJTORISË RAJONALE TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK _____

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhëzimit nr.11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit nr. 107, datë 13.08.2020 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” dhe shkresës nr.133 prot, datë 08.09.2020 “Njoftim për vende të lira pune” të Shkollës së Mesme Profesionale “Sali Ceka”, Elbasan, protokolluar në AKPA me nr.2221 prot, datë 10.09.2020,

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ju njofton shpalljen e procedurave të **lëvizjes paralele** për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale, në Shkollën e Mesme Profesionale “Sali Ceka”, Elbasan, për pozicionin:

- 1 mësimdhënës i teorisë profesionale në drejtimin Ekonomi-Biznes

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në Shkollën e Mesme Profesionale “Sali Ceka”, Elbasan

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në Shkollën e Mesme Profesionale “Sali Ceka”, Elbasan, si vijon:

- a) të ketë diplomë nga një institucion i arsimit të lartët të nivelit master i profesionit ose master i shkencave ose të barasvlershme, për një nga profilet që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

2.Vendi dhe afati i dorëzimit të dokumentave

Aplikantët duhet të dorëzojnë kërkesën për lëvizje paralele dhe dokumentacionin përkatës pranë Shkollës së Mesme Profesionale “Sali Ceka”, Elbasan, brenda 5 ditëve nga njoftimi. Afati i njoftimit fillon më datë 17.09.2020.

Nëse nuk paraqiten kërkesa për lëvizje paralele brenda afatit të mësipërm, Shkolla e Mesme Profesionale “Sali Ceka”, Elbasan, të fillojë procedurën për shpalljen e vendit të lirë, për pozicionin:

- 1 mësimdhënës i teorisë profesionale në drejtimin Ekonomi-Biznes në zbatim të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”.

Shkolla e Mesme Profesionale “Sali Ceka”, Elbasan, brenda 5 ditëve pune pasi është mbyllur procedura e lëvizjes paralele dhe nuk është paraqitur asnjë kërkesë për lëvizje paralele, shpall njoftimin për vendin e lirë në faqen zyrtare të AKPA-s, në faqen elektronike zyrtare të Shkollës së Mesme Profesionale “Sali Ceka”, Elbasan, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të Shkollës së Mesme Profesionale “Sali Ceka”, Elbasan.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Elira DEMIRAJ

